



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 27 maj 2014

Numri i lëndës: 2014-06

B.Y.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 maj 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 6 shkurt 2014.

II. FAKTET

2. Ankuesi pohon se ai rregullisht sulmohet nga fqinjët e tij me *"një laser apo një bateri me laser"*. Për shkak të këtyre sulmeve me laser ankuesi nuk ka mundësi të jetoj jetë normale në shtëpinë e tij dhe në oborrin e tij.
3. Sipas ankuesit, ai dhe familja e tij sulmohet ditën dhe natën, ndërsa anëtarët e familjes janë djegur në të gjithë trupin. Është paraqitur se *"rrezatimi është i lartë dhe si rezultat pësojmë lëndime të rënda trupore kur goditemi nga ky laser"*. Thuhet se, këto sulme janë të vazhdueshme për më shumë se një vit e gjysmë dhe janë duke vazhduar ende.
4. Ankuesi pohon se ai e ka kontaktuar policinë në Pejë 18 herë, mirëpo ata nuk kanë reaguar siç duhet.
5. Më 11 dhjetor 2013, një prokuror i EULEX-it ka informuar ankuesin se i ka shqyrtuar me kujdes dokumentet e tij që i kishte marrë më 20 nëntor 2013. Prokurori i EULEX-it ka informuar ankuesin se më 23 shtator 2013, Prokuroria Themelore në Pejë ka hedhur poshtë raportin penal të paraqitur nga ankuesi më 9 korrik 2013, duke qenë se *"i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme"* në këtë rast. Ankuesi është informuar se *"në bazë të informacionit të marrë, nuk ka [pasur] asnjë arsye që prokurori i EULEX-it të ndërhyjë"*.
6. Më 23 dhjetor 2013, zyra e prokurorisë së EULEX-it ka pranuar një ankesë në lidhje me të njëjtën çështje nga ankuesi. Më 5 shkurt 2013, një prokuror i EULEX-it ka informuar ankuesin se rasti i tij ishte shqyrtuar me kujdes dhe se e njëjta ankesë ishte parashtuar më parë nga ankuesi, për të cilin prokuroria e EULEX-it tashmë iu ishte përgjigjur më 11 dhjetor 2013.
7. Përveç kësaj, prokurori i EULEX-it ka informuar ankuesin në lidhje me mundësinë për t'u ankuar kundër Policisë së Kosovës në Inspektoratin Policor të Kosovës. Ankuesi është informuar se rasti i tij nuk ka hyrë në kuadër të kompetencave të prokurorëve të EULEX-it dhe se lidhur më këtë rast nuk do të ndërmerret asnjë hap i mëtejshëm.

III. ANKESAT

8. Ankuesi në thelb ankohet për mosveprim nga ana e Policisë së Kosovës dhe kërkon nga prokuroria e EULEX-it t'i shqyrtojnë akuzat e tij.

III. LIGJI

9. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
10. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
11. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
12. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të ndërmarra në kontekst të hetimeve penale ishin pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe prandaj kjo bie në kuadër të mandatit të Panelit të EULEX-it (për shembull shih, *I kundër EULEX-it*, 2013-01, 27 nëntor 2013, paragrafi 12; *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, në par. 20-22; *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013 në par. 32; *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012 në par. 21; *Hoxha kundër EULEX-it*, 2011-18, 23 nëntor 2011 në par. 22; *S.M. kundër EULEX-it*, 2011-11, 23 nëntor 2011 në par. 15).
13. Paneli më tej ka konstatuar se veprimet ose mosveprimet nga ana e prokurorëve gjatë fazës hetimore të procedurës penale mund të mos konsiderohen se janë bëra në kuadër të “procedurave gjyqësore” (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, par. 64). Është konstatuar se “*veprimet dhe mosveprimet e prokurorëve të EULEX-it [...] para ngritjes së aktakuzës mund të bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it*” (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, par. 93).
14. Në lidhje me rastin në fjalë, Paneli thekson deklaratën e prokurorit të EULEX-it se autoritetet (vendore) të prokurorisë kanë kryer “të gjitha veprimet e nevojshme” në këtë lëndë.
15. Paneli konstaton se autoritetet e prokurorisë së EULEX-it kanë shqyrtuar këtë lëndë dy herë dhe kanë vendosur mos ta hetojnë këtë lëndë. Ndërsa do të ishte e pëlqyeshme që të ofrohen arsyet për refuzimin e marrjes përsipër të kësaj lëndë, Paneli konstaton vendimet e prokurorit të shtetit të Kosovës, i cili pas shqyrtimit të pretendimeve të ankuesit ka vendosur se nuk është kryer asnjë vepër penale e shkaktimin të rrezikut të përgjithshëm.

16. Prandaj, Paneli nuk mund të nxjerr përfundim se këto vendime janë marrë nga prokurorët e EULEX-it në mënyrë arbitrare. Për më tej, në bazë të informatave në dispozicion të Panelit, nuk mund të nxirret si përfundim se vepra e dyshuar penale do të bie në kuadër të autoritetit të prokurorëve të EULEX-it në bazë të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it. Së fundi, Paneli konstaton se prokurori i EULEX-it ka informuar ankuesin rreth mundësisë së paraqitjes së ankesës së tij në lidhje me dyshimin për mos veprim nga ana e Policisë së Kosovës në Drejtorinë e Policisë së Kosovës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese